

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6498  
E martë, 28 dhjetor 2021  
çmimi 0.40

## Hekurudha Kosovë - Shqipëri nis punimet në vitin 2024



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PROTESTOHET KUNDËR GJENDJES SË RËNDË ENERGETIKE NË VEND

# ALTERNATIVA E KURTTIT: OSE REDUKTIME, OSE SHTRENJTIM TË RRYMËS!



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vazhduar t'i fajësojë qeveritë e kaluara për gjendjen e rëndë energjetike në vend. Ai ka thënë Kosova ndodhet në këtë gjendje për shkak të mungesës së vizionit për zhvillim socio-ekonomik të sektorit energjetik dhe korrupsionit qeveritar. Sipas tij, Kosova ka dy zgjidhje: ose reduktime të energjisë ose shtrenjtim të energjisë. Ndërsa pakënaqësitë qytetare ndaj gjendjes së krijuar në vend, sidomos pas shkurtimeve të energjisë elektrike, janë rritur

## AKTUALE



97 TË VDEKUR NË AKSIDENTE TRAFIKU NË KOSOVË PËR 10 MUJ

KFOR-I PËRFORCON NJËSITET USHTARAKE NË KOSOVË

RRETH 4 000 PERSONA HOQËN DORË NGA SHTETËSIA NË VITIN 2021



## EKONOMI



MUNGESA E RRYMËS ÇRREGULLON PUNËN E BIZNESEVE

## SPORT



SHËNUESIT MË TË MIRË NË SUPERLIGËN E MESHKUJVE DHE FEMRAVE

## Kaosi në udhëtime hyn në javë të re



## OMICRONI EDHE NË KOSOVË, NËNTË RASTE TË REJA

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Kaosi në udhëtime hyn në javë të re

**NJU-JORK, 27 DHJETOR** - Në botë janë regjistruar më shumë anulime fluturimesh të lidhura me koronavirus, duke krijuar atmosferë të mjerueshme për mijëra njerëz në fund të vitit.

Më shumë se 1 400 fluturime janë anuluar të hënën, më 27 dhjetor, derisa Kina dhe Shtetet e Bashkuara janë destinacionet e goditura më së keqi, sipas të dhënave të faqes "FlightAware".

Kompanitë ajrore amerikane kanë thënë se anulimet janë rezultat i testimit të anëtarëve të stafit që kanë rezultuar pozitivë, ose është dashur të izolohen.

Hong-Kongu ka ndalur të gjitha fluturimet me Korenë Jugore për dy javë, pas identifikimit të rasteve pozitive në mesin e udhëtarëve nga ky shtet.

Në total, më shumë se 8 000 fluturime janë anuluar prej të premtes, kur edhe ka nisur të festohet Krishtlindja.

Ndonëse numri i fluturimeve të anuluar është i vogël në krahasim me totalin e atyre që janë realizuar, kjo shifër është më e lartë sesa zakonisht dhe vjen në kohën kur shumë njerëz udhëtojnë për të kaluar kohë me familjen dhe miqtë.

Ndërkohë, autoritetet amerikane janë duke vëzhguar dhjetëra anije në të cilat ka raste pozitive me koronavirus teksa po lundrojnë në ujërat amerikane.

Sipas agjencisë së lajmeve AFP, disave u është mohuar ankorimi në portet e Karaibeve.

Numri i rasteve të infektimit me koronavirus është duke prekur nivele rekorde në gjithë botën, kryesisht për shkak të variantit Omicron, transmeton REL.

Pavarësisht prej gjetjeve të fundit, se Omicroni përcillet me simptoma më të lehta se variantet e tjera, shkencëtarët janë të shqetësuar nga numri i madh i rasteve të raportuara.

Shumica e fluturimeve të anuluar të hënën janë të kompanive kineze, sipas "FlightAware".

Aty përfshihen "China Eastern" me 368 fluturime të anuluar dhe "Air China" me 141.

Aeroportet në Pekin dhe në Shangai duket se janë goditur më së keqi me gati 300 fluturime të anuluar në kombinim.

Autoritetet kineze nuk e kanë komentuar ende këtë situatë.

Aeroporti i qytetit kinez, Xi'an,



është po ashtu në listë.

Më shumë se 13 milionë njerëz në këtë qytet janë izoluar teksa autoritetet tentojnë të luftojnë një shpërthim të koronavirusit. Në Shtetet e Bashkuara kompanitë më të goditura janë Unitedi me 84 anulime dhe JetBlue me 66.

Kompania United ka paralajmëruar javën e kaluar se rritja e rasteve të infektimit ka

pasur "ndikim të drejtpërdrejtë në staf" pasi shumë njerëzve u është kërkuar të vetizolohen pas kontaktit me persona të infektuar.

Varianti Omicron i koronavirusit tani është variant dominues në ShBA, por edhe moti i lig është faktor në këtë situatë.

Bora ka shtyrë realizimin e disa fluturimeve në Uashington

ditën e diel.

Në Mbretëri të Bashkuar janë anuluar 42 fluturime më 27 dhjetor.

Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën janë regjistruar 280 milionë raste të infektimit. Përgjatë kësaj periudhe është raportuar edhe për 5.4 milionë vdekje të lidhura me këtë virus.

## Lavrov: Bisedimet me ShBA-në për sigurinë, pas festive

**MOSKË, 27 DHJETOR** - Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, tha se bisedimet ndërmjet Uashingtonit dhe Moskës, lidhur me çështjet e sigurisë, do të mbahen pasi të përfundojnë festat në Rusi. Ai tha, po ashtu, se Rusia dëshiron që zyrtarët ushtarakë të përfshihen në bisedime me Aleancën Veri-Atlantike (NATO).

Duke folur në një program televiziv më 27 dhjetor, Lavrov tha se "ne do të mbajmë raund të madh të bisedimeve për sigurinë me Shtetet e Bashkuara, menjëherë pas përfundimit të festave të Vitit të Ri".

Rusia feston Krishtlindjen Ortodokse më 7 janar, që nënkupton se festë do të jetë deri më 10 janar.

Komentet e Lavrovit erdhën pas rritjes së tensioneve ndërmjet Moskës dhe Uashingtonit për shkak të grumbullimit masiv të trupave ruse pranë kufirit me Ukrainën dhe kërkesave të Kremlinit që NATO-ja të mos



zgjerohet më në lindje.

Presidenti rus Vladimir Putin, gjatë konferencës vjetore me gazetarë, i bëri thirrje Perëndimit që t'i pranojë kërkesat ruse

"menjëherë" dhe përmendi një sërë ankesash karshi Ukrainës dhe NATO-s.

Ndërkaq, më 26 dhjetor, në një intervistë të publikuar nga

transmetuesi shtetëror rus, Putini tha se Rusia po shqyrton disa opsione nëse Perëndimi nuk plotëson kërkesat e Moskës. Ai nuk dha detaje se cilat janë këto

opsione, por shtoi se "do të varet nga propozimet që do të më japin ekspertët tanë ushtarakë".

Lavrov, po ashtu, tha se Rusia dëshiron që në bisedimet eventuale me NATO-n të përfshihen zyrtarët ushtarakë dhe kritikoi Aleancën, duke përsëritur qëndrimin se Moska nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj, siç tha ai, agresionit të NATO-s në afërsi të Rosisë. "NATO tani është projekt i pastër gjeopolitik për të zhvilluar një territor që ka mbetur pa pronar që prej zhdokjes së (Organizatës) Paktit të Varshavës dhe pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Kjo është ajo që ata po bëjnë", tha Lavrov.

Komentet e Lavrovit erdhën një ditë pasi Ministria e Jashtme ruse pranoi se sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka propozuar që të mbahet një takim më 12 janar i Këshillit NATO - Rusi. Kremlini ende nuk ka treguar nëse do të marrë pjesë në këtë takim.

# OMICRONI EDHE NË KOSOVË, NËNTË RASTE TË REJA

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se ka detektuar nëntë raste me variantin Omicron të koronavirusit. Sipas njoftimit, dy raste janë të importuara nga Shtetet e Bashkuara, dy nga Londra e Mbretërisë së Bashkuar, një nga Franca dhe katër raste me variantin Omicron të detektuar janë në komunën e Mitrovicës, të cilët mohojnë historinë e udhëtimit dhe se kanë pasur kontakte me dikë nga jashtë. “Pas paraqitjes së variantit Omicron (B.1.1.529) në botë, Evropë, rajon e tashmë edhe në Kosovë, parashikohet rëndimi i situatës epidemiologjike”, ka njoftuar IKShPK-ja.

IKShPK-ja ka theksuar se testimi është kryerë me kit-e shtesë që kanë pranuar përmes Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ky institut kishte paralajmëruar më 23 dhjetor se do të pajisej me këto kite me qëllim që ta detektojë variantin e ri Omicron.

Ekspertët shëndetësorë në Kosovë kanë thënë se simptomat e gripit stinor dhe variantit Omicron janë të ngjashme, prandaj ata kanë kërkuar që diferencimi të bëhet përmes testeve laboratorike.

Ndërkaq disa studime të kryera në botë kanë sugjeruar se varianti Omicron mund të jetë më i lehtë se “Delta” i cili aktualisht është variant dominues në Kosovë. Më herët, gjatë dhjetorit, Kosova dërgoi mbi 70 mostra pozitive për analizim në një laborator në

Gjermani për të parë nëse në to kishte prani të variantit Omicron. Ky variant i ri i Covid-19 fillimisht u detektua në Afrikën e Jugut në muajin nëntor. Që atëherë është përhapur në mbi 90 shtete të botës.

Omicroni besohet se transmetohet më shpejt se variantet paraprake, por shkencëtarët ende nuk kanë përcaktuar nëse ai shkakton sëmundje më të rëndë apo nëse shmang mbrojtjen që ofrojnë vaksinat ekzistuese kundër koronavirusit.

Raste me Omicron janë regjistruar edhe në vendet e rajonit: Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi.

Për dallim nga shtetet e tjera në rajon dhe Evropë, situata epidemiologjike në Kosovë është më e qetë dhe aktualisht janë 343

raste aktive me koronavirus.

Vaksinat kundër koronavirusit nuk ofrojnë aq shumë mbrojtje ndaj Omicronit siç ofrojnë ndaj varianteve paraprake të koronavirusit.

Vaksinat, megjithatë, ndihmojnë shumë.

Rezultatet laboratorike tregojnë se të paktën dy doza të vaksinës mund të mos jenë të mjaftueshme për ta parandaluar infektimin, por një dozë përforcuese e kompanisë “Pfizer” apo “Moderna” prodhon antitropa që e luftojnë virusin, mjaftueshëm sa për t’iu kundërvënë Omicronit.

Nivelet e antitropave bien pas një kohe dhe marrja e një doze përforcuese bën që nivelet të ngriten sërish. Nëse një person merr dozë përforcuese “Pfizer” atëherë niveli i antitropave rritet

për 25 herë.

Në Kosovë, më 9 dhjetor, ka filluar administrimi i dozës përforcuese dhe dozës së tretë të vaksinës kundër koronavirusit.

Doza përforcuese u jepet qytetarëve gjashtë muaj pas marrjes së dozës së dytë të vaksinës, kurse doza e tretë u jepet personave të cilët i kanë marrë dy dozat e vaksinës kundër Covid-19, por te të cilët nuk është zhvilluar imuniteti i duhur si pasojë e imunitetit të dobët të tyre, apo sëmundjeve shoqëruese, me rekomandim të mjekut ordinues. Dozën përforcuese dhe dozën e tretë do të mund ta marrin të gjithë personat mbi 18 vjeç. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, qytetarët do të njoftohen për datën e vaksinimit përmes mesazheve telefonike, emailit dhe njoftimeve publike.

## 97 të vdekur në aksidente trafiku në Kosovë për 10 muaj

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Dy të vdekur është bilanci i aksidentit që ndodhi mbrëmë në fshatin Zajm të Klinës, ku të përfshirë ishin një kamion dhe një veturë. Në mesin e viktimave ishte edhe një fëmijë rreth moshës tetëvjeçare.

Në periudhën janar-tetor në aksidente trafiku në Kosovë jetën e humbën 97 persona në 86 aksidente që përfunduan me fatalitet. Kështu thuhet në një

përgjigje për “Klankosova.tv” nga Policia e Kosovës.

Sipas të dhënave të policisë, gjatë kësaj periudhe ndodhën gjithsejtë 6 259 aksidente me lëndime e ku u lënduan 12 114 persona. Po ashtu, pati edhe 11 172 aksidente me dëme materiale.

Policia e Kosovës thekson për “Klankosova.tv” vazhdimisht i ka zhvilluar aktivitetet e saj me qëllim të parandalimit të aksidenteve

dhe ngritjes së sigurisë në trafik.

Përgjatë kësaj kohe nuk mungoi edhe disiplinimi i shoferëve me masa adekuate. 313 384 gjoba u shqiptuan në trafik nga muaji janar e deri në shtator të këtij viti.

Nga policia pati edhe masa të tjera të rrepta ndaj vozitësve të papërgjegjshëm. Një nga masat më të rrepta është konfiskimi i patentshoferëve.





PROTESTOHET KUNDËR GJENDJES SË RËNDË ENERGETIKE NË VEND

## Alternativa e Kurtit: Ose reduktime, ose shtrenjtim të rrymës!

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vazhduar t'i fajësojë qeveritë e kaluara për gjendjen e rëndë energjetike në vend. Ai ka thënë Kosova ndodhet në këtë gjendje për shkak të mungesës së vizionit për zhvillim socio-ekonomik të sektorit energjetik dhe korrupsionit qeveritar. Sipas tij, Kosova ka dy zgjidhje: ose reduktime të energjisë ose shtrenjtim të energjisë. Ndërsa pakënaqësitë qytetare ndaj gjendjes së krijuar në vend, sidomos pas shkurtimeve të energjisë elektrike, janë rritur

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 27 DHJETOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, sërish ka folur për krizën energjetike në vend, duke treguar faktorët që kanë sjellë një gjendje të tillë. Në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka shkruar se çmimet e larta të importit janë pasojë e faktorëve të jashtëm, ndërkaq

dobësimi i kapaciteteve është pasojë e shkaqeve të brendshme. Sipas tij, qytetarët i kanë dy zgjidhje: ose reduktime të energjisë ose shtrenjtim të energjisë. "Edhe Kosova është në krizë energjetike. Çmimet e larta të importit janë pasojë e faktorëve të jashtëm, ndërkaq dobësimi i kapaciteteve është pasojë e shkaqeve të brendshme. Në njërën anë, çmimi i energjisë në bursë

është shtatëfishuar: ishte rreth 70 euro për MWh në kushte normale, kurse më 21 dhjetor mbërriti deri në 515 euro! Në anën tjetër, as gjysma e konsumit të ne nuk mbulohet nga prodhimi: kërkesa ka arritur pikun historik me 1,4 GW, ndërsa në rastin më të mirë (derisa ta riparojmë bllokun B2 me fuqi prej 255 MW) termoelektranat tona nuk gjenerojnë as 650 MW! Në këtë situatë nuk ka zgjidhje të mirë: ose reduktime të energjisë, ose shtrenjtim të energjisë?", ka shkruar Kurti. Sipas tij, shumë më herët Kosova është dashur të mendojë që të mos përfundojë në këtë gjendje të keqe. "Janë dy faktorë të brendshëm që na kanë sjellë në këtë krizë. Mungesa e vizionit për zhvillim socio-ekonomik të Kosovës, me planifikim të

sektorit energjetik për furnizim të qëndrueshëm dhe çmime të përballueshme, si për amvisëritë ashtu edhe për industrinë. Së dyti, korrupsioni qeveritar i bërë zakon, e që kulmoi me privatizimin e rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit për vetëm 26 milionë euro. Gjatë këtyre dy dekadave projektet e ndryshme pa strategji afatgjatë nuk kishin si të mos dështonin. Në vitin 2022 ne do ta kemi strategjinë nacionale energjetike për dekadën në vijim, dhe shtigjet ku duhet ecur drejt vitit 2050", është shprehur ai. Megjithatë, kryeministri Kurti ka thënë se situata në vend ka nisur të normalizohet. "Unë dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, jemi në komunikim të rregullt me KEK-un, KOSTT-in dhe ZRrE-

në. Me shtimin e likuiditetit dhe subvencionimin e importit kemi arritur ta stabilizojmë furnizimin dhe reduktimet pothuajse janë hequr. Po bëjmë krejt çka mundemi. Ju faleminderit për mbështetjen dhe ju lutemi për kursim e racionalizim të shpenzimit me aq sa mundeni", ka shkruar Kurti.

### Protestohet kundër gjendjes së rëndë energjetike

Dhjetëra qytetarë kanë protestuar të hënën para ndërtesës së Kompanisë së Kosovës për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) për ta kundërshtuar mungesën e energjisë elektrike. Ata kanë kërkuar furnizim të rregullt me rrymë dhe shkarkimin e

## KFOR-i përforcon njësitet ushtarake në Kosovë

**PRISHTINË, 27 DHJETOR** - KFOR-i ka njoftuar se i kanë arritur automjetet dhe pajisjet ushtarake të Batalionit Rezervë Operacional nga Hungaria. Këto njësi do të stacionohen në Kosovë për ta përmbyshur misionin. Këto njësi janë në

shumë me ardhjen e automjeteve dhe pajisjeve të Batalionit Rezervë Operacional nga Hungaria. Këto njësi do të stacionohen në Kosovë për ta përmbyshur misionin. Këto njësi janë në

gjendje t'i përforcojnë njësitet aktuale të KFOR-it sa herë që është e nevojshme. Batalioni i Rezervës Operative është tashmë në funksion", është thënë në njoftimin për medie.



ministres së Ekonomisë, Artane Rizvanolli. Ata kanë gjuajtur me poçe elektrike ndërtesën e kompanisë, duke bërë thirrje që KEDS-i duhet të nacionalizohet. “Kjo kompani i përket Kosovës. Kjo kompani është shitur për një copë bukë. Nga viti 1999-2012 KEK-u ka investuar mbi 180 milionë euro, pra është shitur për një të shtatën pjesë. Për tetë vjet i kanë deklaruar fitime prej 140 milionë eurosh, pra nga 17 milionë euro në vit”, ka deklaruar Dibran Hoxha, një nga organizatorët e protestës. Sipas tij, me ndarjen e 20 milionë eurove nga Qeveria e Kosovës për prodhimin e energjisë elektrike, qytetarët

po ua paguajnë dy herë faturën KEDS-it.

“Në vendet periferike, përveç që po ndalet rryma, po ndalet edhe uji. Qeveria e Kosovës i ka ndarë 20 milionë euro, ne po ia paguajmë KEDS-it dy herë faturën. Pra, ne ia paguajmë dy herë faturën, kurse qeveria kur të ka nevojë. Pse na duhet t’ia mbajmë barrë fitimin një kompanie private. Hajde ta nacionalizojmë! Ne duhet t’ua blejmë nga një biletë këtyre investitorëve”, ka përfunduar ai.

Më pas protesta ka vazhduar para ndërtesës së qeverisë. Edhe këtu protestuesit kanë përsëritur kërkesën e shkarkimit të ministres

Rizvanolli dhe nacionalizimin e KEDS-it.

Protestuesit janë shpërndarë të qetë, duke paralajmëruar protesta të reja.

Të premtën Qeveria e Kosovës ka njoftuar se ka vendosur për masa të emergjencës në furnizim të energjisë elektrike, të cilat do të vlejnjë maksimalisht 60 ditë.

Sipas vendimit të qeverisë, masat emergjente në furnizim me energji përfshijnë: Vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët, dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.

Gjithashtu, thuhet se qeveria mund ta fillojë zbatimin e

masave menjëherë, por se vendimi duhet të shqyrtohet për miratim edhe nga Kuvendi i Kosovës në afat prej shtatë ditësh.

Kuvendi ka të drejtën e refuzimit të masave dhe në këtë rast qeveria është e obliguar t’i ndërpresë ato. “Sistemi elektro-energjetik i Kosovës aktualisht është duke u përballur me vështirësi të theksuara si reflektim i rritjes së theksuar të konsumit të energjisë elektrike në vend, pamjaftueshmërisë së gjenerimit të brendshëm për ta mbuluar konsumin, dhe krizës globale energjetike që ka rezultuar me rritjen enorme të çmimit të energjisë

elektrike në bursat ndërkombëtare”, është thënë në arsyetim e Qeverisë së Kosovës për këto masa.

Qeveria më tej arsyeton masat me faktin se problemet me furnizim me energji elektrike janë paraqitur sidomos gjatë muajit dhjetor të këtij viti për shkak të avarive të shkaktuara në gjeneratorët e termocentralit “Kosova A” dhe “Kosova B”.

Qeveria ka formuar një komitet teknik emergjent në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë që ka për qëllim identifikimin dhe paraqitjen e rekomandimeve për Ministren e Ekonomisë së Kosovës.



## Italia, amendament për njohjen e pensioneve të shqiptarëve

TIRANË, 27 DHJETOR - Parlamenti italian ka përfshirë në projektbuxhetin e Italisë për vitin 2022 edhe një amendament për nisjen e procesit të njohjes faktike të pensioneve të shqiptarëve me kontribute pune në këtë vend.

Lajmi është bërë me dije nga kryeministri Edi Rama, i cili

përmes një postimi në faqen e vet në “Facebook”, shprehet se nga ana e qeverisë shqiptare vijnë kontaktet deri në aprovimin përfundimtar të projektbuxhetit 2022. “Me këtë rast u shpreh mirënjohjen në emër të shqiptarëve në Itali, kryeministrit Mario Draghi,

ministrit të Jashtëm Luigi di Maio, të cilët janë angazhuar personalisht për ta zgjidhur këtë çështje kaq jetike për aq shumë shqiptarë të mirë në Italinë mike, si dhe të gjithë të tjerëve që dashamirësisht janë përfshirë në këtë përpjekje të përbashkët”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



## Hekurudha Kosovë - Shqipëri nis punimet në vitin 2024

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, ka thënë se procesi i Berlinit është shtylla kryesore e marrëdhënieve të gjithë rajonit dhe se është e rëndësishme që në këto nisma të ketë një gjithë përfshirje. Ai thotë se fokusi kryesor i të dyja vendeve duhet të jetë zbatimi i marrëveshjeve të arritura në mbledhjen e dy

qeverive mbajtur në Elbasan, ku u nënshkruan 13 marrëveshje. “Duhet të theksojmë se procesi i Berlinit është shtylla kryesore jo vetëm e marrëdhënieve Shqipëri - Kosovë, por edhe e marrëdhënieve të gjithë rajonit. Është një proces që ka filluar më parë, por nga ana tjetër ashtu siç është thënë edhe faktori ndërkombëtar do të kishte mirëpritur edhe nisma të tjera që

vendet e rajonit mund të kenë, por e rëndësishme është që në këto nisma të ketë një gjithëpërfshirje. Prandaj edhe një herë theksoj nuk do t'i mëshojmë kësaj teme kaq shumë, por duhet të shikojmë se si po realizohen marrëveshjet midis dy qeverive dhe me kënaqësi mund të them se ky proces tashmë ka filluar të gjejë frymën e zbatimit. Prandaj nuk

duhet ta humbim fokusin. Duhet të merremi me atë që kemi përcaktuar në mbledhjen e fundit që u mbajt në Elbasan. Dhe ajo që dua të them është se vendimet e kësaj mbledhjeje kanë një rëndësi shumë të madhe për Shqipërinë dhe Kosovën në të gjitha drejtimet. Prandaj ne nuk duhet të shpërqendrohemi nga fokusi”, u shpreh ai.

Minxhozi për ndërtimin e hekurudhës Durrës - Prizren tha se do të jetë një hap shumë i rëndësishëm për ekonominë e të dyja vendeve, raporton “Ekonomia Online”. Sipas tij, në vitin 2023 do të fillojë faza e projektimit të hekurudhës në mënyrë që nga viti 2024 të fillojnë punimet për hekurudhën e re që do ta lidhë Shqipërinë me Kosovën.



## Rreth 4 000 persona hoqën dorë nga shtetësia në vitin 2021

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Rreth 4 600 kosovarë kanë hequr dorë nga shtetësia gjatë vitit 2021. Ky numër është dukshëm më i lartë se një vit më herët kur nga shtetësia kishin hequr dorë 3 600 persona. Zyrtarë nga Ministria e Punëve të Brendshme thonë se arsyeja kryesore për heqjen dorë nga shtetësia është moslejimi i dyshtetësisë në shtete të ndryshme, kryesisht të Bashkimit Evropian, ku kanë migruar shumë kosovarë. Ndryshe nga viti 2020, kur nga shtetësia e Kosovës hoqën dorë rreth 3 600 persona, numri i kosovarëve që janë liruar nga shtetësia deri në fund të nëntorit të këtij viti është dukshëm më i



lartë se vitin e kaluar.

Behar Haziraj, zyrtar i lartë për medie në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës,

tregon numrin e atyre që për arsye të ndryshme hoqën dorë nga shtetësia, shkruan “RTKlive”. “Gjatë periudhës janar-nëntor të

vitit 2021 nga Shtetësia e Republikës së Kosovës janë liruar gjithsej 4 594 persona. Prej këtyre, meshkuj janë 2 359, ndërsa 2 235 femra. Këto janë të dhëna statistikore të përpunuara deri në muajin nëntor, ndërsa meqë muaji dhjetor nuk ka përfunduar ende, të dhënat për këtë muaj nuk i kemi”.

Arsyeja kryesore që i shtyn kosovarët të heqin dorë nga shtetësia është ndalimi i dyshtetësisë në shumë vende të BE-së, pohon Haziraj. “Arsyet pse këta persona heqin dorë nga shtetësia e Kosovës është pasi që shumë shtete të Bashkimit Evropian nuk lejojnë dyshtetësinë, përfshirë këtu

edhe disa shtete që nuk janë pjesë e BE-së. Duke pasur parasysh që një numër i madh i shtetasve tanë jetojnë tashmë me vite në këto shtete, e një numër i madh edhe kanë lindur në këto shtete dhe si rezultat i saj kanë fituar të drejtën e Fitimit të Shtetësisë dhe janë të obliguar të lirohen nga shtetësia e mëparshme në rast se dëshirojnë ta fitojnë shtetësinë e atij vendi”, ka thënë Haziraj.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2021 shtetësinë e Kosovës e kanë fituar 362 persona.

Ndërkohë, sipas të dhënave të MPB-së, nga 2017 deri në vitin 2020 nga shtetësia kanë hequr dorë 20 113 kosovarë.

## Organizohet testi i inteligjencës për rekrutët e FSK-së, Mehaj: Do t'i kalojnë më të mirët

Prishtinë, 27 dhjetor - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka bërë me dije se pas testimit fizik, në pesë kazernat e FSK-së është organizuar testi i inteligjencës dhe njohurive të përgjithshme për kandidatët e konkursit për ushtarët e rinj të FSK-së.

Mehaj ka thënë se në këtë test do të kalojnë vetëm më të mirët. “Të gjithë kandidatëve u uroj suksese dhe i garantojmë se do të kalojnë vetëm më të mirët. Transparenca si dhe parimi i meritokracisë dhe mundësisë së barabartë është moto e

qeverisjes sonë”, ka shkruar Mehaj në llogarinë e vet në “Facebook”. Kujtojmë se Ministria e Mbrojtjes më 21 tetor të këtij viti ka shpallur konkurs për rekrutimin e 840 ushtarëve të rinj të Forcës dhe Sigurisë së Kosovës.



## Mungesa e rrymës çrregullon punën e bizneseve

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Kriza energjetike në Kosovë, e cila ka shkaktuar kufizime të furnizimit me rrymë për konsumatorët, po e çrregullon punën e biznesit të Abedin Salihut, i cili është i shtrirë në sektorin e ndërtimit dhe prodhimit të produkteve të betonit dhe hoteleri.

"Jemi detyruar të mbyllim disa sektorë", thotë për "Radion Evropa e Lirë", Salihu, pronar i "Dino Company" nga Lipjani, që ka rreth 270 punëtorë.

Situata me energjinë elektrike, shton ai, e detyroi ta shkurtojë edhe numrin e punëtorëve. "Dino Company" është një nga kompanitë në Kosovë e cila eksporton produkte jashtë vendit dhe, si e tillë, Salihu thotë se ka obligime edhe ndaj kompanive me të cilat ka kontrata për eksport. "... Ata mund të na gjobitin. Ne nuk kemi kontrata që mund t'u themi se shteti na ndali rrymën dhe nuk mund të vazhdojmë më", thotë Salihu.

E gjithë kjo situatë, shton ai, po dëmton edhe besimin e

partnerëve të biznesit që, siç thotë ai, e kanë krijuar me shumë mund përgjatë 20 vjetëve. "Kjo situatë me energji do ta çrregullojë punën tonë, çmimet në treg, do ta çrregullojë ekonominë", thotë ai.

Që nga 22 dhjetori konsumatorët në Kosovë po përballen me shkurtime të energjisë elektrike. Kjo situatë po krahasohet me situatën e pasluftës (1999), kur shkurtime të energjisë ishin të gjata, deri në 8 orë pa rrymë.

Por, për pronarin e "Dino Company", Abedin Salihu, kjo situatë është edhe më e keqe se në kohën e pasluftës kur ai kishte themeluar kompaninë. "Pas luftës nuk kemi pasur aq shumë punë, kemi qenë në fazën emergjente. Tani jemi rritur. Si kompania ime dhe shumë të tjera kemi gjetur një rrugë ku mund të punojmë, kemi rritur biznesin, kemi obligime. Të vendosësh tani një barrikadë të tillë është papërgjegjësi", thotë ai.

Gjeneratorët, të cilët në kohën e pasluftës ishin përdoruar në

numër të madh nga bizneset, tani Salihu thotë se i takojnë së kaluarës. Sipas tij, kompania e tij e ka të pamundur të funksionojë me gjeneratorë. "Për dy orë agregati shpenzon 100 euro. Për të pasur, për shembull, hoteli rrymë, i bie në ditë minimumi harxhon 1 000 euro. Unë nuk i kam 1 000 euro fitim në ditë, nuk mund të punojmë me humbje. Vetëm për punën në gurthyes do të duhej një agregat 500 kw që kushton rreth 400 mijë euro", thotë ai.

Situata energjetike është përkeqësuar pasi konsumi i energjisë nuk po mund të mbulohet nga kapacitetet prodhuese të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Sipas zyrtarëve të Kompanisë së Kosovës për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS), Kosova aktualisht prodhon 600 deri në 800 megavatë rrymë në orë, kurse konsumi ka arritur deri në 1 400 megavatë në orë.

Në tregun botëror çmimi i rrymës është shtrenjtuar dukshëm. Nga 69 euro për megavat sa ishte

çmimi vitin e kaluar, në këtë periudhë çmimi i importit të rrymës arriti deri në 600 euro për megavat, ka thënë zëdhënësi i Kompanisë Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike, Viktor Buzhala.

Por edhe procesi i importit është vështirësuar për shkak të mungesës së këtij produkti në shtetet e tjera.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini (AKB), thotë se nga mungesa e energjisë humbjet do të jenë të mëdha për bizneset. Ai shtoi se brenda javëve do të dalin edhe me të dhëna të sakta lidhur me humbjet që pësuan bizneset nga kjo situatë. "Kjo na bën që edhe më tutje të ngecim në prodhim, shërbime e aktivitete të përditshme. Me lajmet që po rrjedhin nga Kosova, se vendit po i kthehet terri, është dëmtrim i imazhit tek investitorët potencialë. Është e paimagjinueshme të mendohet që në Kosovë nuk ka energji elektrike", thotë Shahini.

Qeveria po kërkon vazhdimisht

nga qytetarët që ta kursejnë rrymën.

KEDS-i fillimisht kishte paraparë që shkurtime të ndërprerjes së energjisë të zgjasin rreth dy orë në ditë, por që kjo nuk ka ndodhur. Shkurtime janë shumë më të gjata. Sipas KEDS-it, shkurtime më shumë se dy orë po ndodhin për shkak të mbingarkesës.

Qeveria e Kosovës më 24 dhjetor vendosi masa të emergjencës për furnizim të energjisë elektrike të cilat do të vlejnjë maksimalisht 60 ditë.

Qeveria mund të fillojë zbatimin e masave menjëherë, por se vendimi duhet të shqyrtohet për miratim edhe nga Kuvendi i Kosovës në afat prej shtatë ditësh. Kuvendi ka të drejtën e refuzimit të masave dhe në këtë rast qeveria është e obliguar t'i ndërpresë ato. Masat emergjente në furnizim me energji përfshijnë: vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.



## Parandalohet kontrabanda përmes autobusit, sekuestrohen pajisje për telefona mobilë dhe kozmetikë



PRISHTINË, 27 DHJETOR - Dogana e Kosovës ka njoftuar se ka parandaluar kontrabandimin e mallrave përmes pikës kufitare të Merdarit në një autobus të linjave ndërkombëtare.

Sipas njoftimit, janë zbuluar mallra të kozmetikës dhe aksesore për telefona mobilë. "Oficerët doganorë në pikëkalimin kufitar të Merdarit kanë ushtruar kontroll në një autobus ku edhe kanë arritur të parandalojnë një sasi të konsiderueshme të mallrave të

cilat barteshin nga një prej udhëtarëve. Sasia e mallrave tregon qartë synimin për rishitje duke tentuar t'i shmangë taksat doganore. Mallrat e zbuluara ishin kozmetike mbi 20 kilogramë, çanta si dhe aksesore për telefona mobilë. Mallrat i janë nënshtruar konfiskimit të menjëhershëm si dhe ndaj personit përgjegjës është iniciuar procedura për kundërvajtje doganore", bëhet me dije në njoftimin për medie të Doganës.

# SHKRIMTARËT SUGJEROJNË: CILËT LIBRA TË DHUROJMË PËR FESTA?

Mira Meksi

Festat e fundvitit hedhin përherë një pluhur magjik në jetën tonë që na bën më imagjinare, por edhe më të gëzuar, edhe kur pesha e pandemisë vazhdon të na rëndojë në zemër. Ëmbëlsirën shpirtërore për këto festa, njëllor si thelbi dhe natyra e tyre, do ta sugjeroja të lehtë, onirike, fantazore, me zhbirime realitetesh paralele dhe zbulime fantastike. Me një fjale, të ndodhë që lexuesi me të shijuar copëzën e parë të saj, ta lerë veten të rrëmbehet nga fantazia, njëllor si gjethja e rënë nga era e vjeshtës, – pothuaj të gjithë përbërësit i propozoj të jenë tregime, mundësisht të shkurtra:

**Vdekja dhe Busulla** – Jorge Luis Borges – Përmbledhje me

tregime nga “Fiksionet” dhe “Alefi”.

Tregimet e tij të jashtëzakonshme bëjnë që lexuesi të përsiatet mbi jetën, dijen dhe gjithçka tjetër, duke u nisur nga fantazia.

**Dymbëdhjetë tregime pelegrine** – G.Garcia Marquez – Thjesht perla të realizmit magjik.

Si aromatizues:

**Rrëfenja gotike** – Robert Louis Stevenson

Magjistari i madh i letërsisë fantastike, ushqyer me legjenda dhe personazhe të errët, me sytë e imagjinare, e kthen irrealen në realitetin e njëmend dhe makthin në një tejz të ndjeshme...

Dhe qershia mbi tortë, i vetmi roman mendoj që i shkon atmosferës së leximit gjatë festave:

**Muzgu i perëndive të stepës** – I.Kadare

Për mua romani më i ndjeshëm dhe më i arrirë i autorit, një lloj autobiografie e mrekullueshme ku shpaloset tërë magjia e teknikës rrëfimtare kadareiane.

Besnik Mustafaj

Petro Marko, **“Retë dhe gurët”** (Intervistë me vetveten)

Një libër krejt i veçantë në opusin e pasur të prozave të Petro Markos, ku autori shpalos me ndershmëri jetën e tij prej shkrimtari të përkushtuar si pjesë e vorbullës historike të Shqipërisë së shekullit XX.

Mitrush Kuteli, **Novelat**

Me novelat e tij, Mitrush Kuteli dëshmoi se gjuha shqipe, edhe pse pa ndonjë përvojë të madhe në prozë deri atëherë, kishte aftësi

të pashtershme për ta shprehur në thellësi dramën e shqiptarit si pasqyrim universal të njeriut.

Ismail Kadare, **“Pallati i ëndrrave”** Ky është, në vlerësimin tim, romani që shënon triumfin përfundimtar të mjeshtrit përballë sistemit politik të represionit mbi fjalën dhe përfytyrimin njerëzor.

Fatos Arapi, **Veptra poetike** deri tani më e plotë, në katër vëllime, të botuara te “Neraida”

Një vepër, e cila e vendos pa mëdyshje poezinë shqipe në tryezën e parë të poezisë së madhe europiane të shekullit XX.

Bashkim Hoxha

Megjithëse Krishtlindje ka në thelbin e vet fjaleën lindje, unë do të sugjeroja disa libra që sjellin vlerat dhe gëzimin e jetës përmes titujve që kanë fjalën vdekje.

Do të ishte një dhuratë e mrekullueshme:

**800 hapa larg Venerës** e Virion Graçit

Një libër i mrekullueshëm për jetën e parë nga pasvdekja. Histori njerëzore të kësaj bote që vazhdojnë në përjetësi. Dhënë me një stil të përsosur dhe karaktere tepër të goditur.

**Vdekja më vjen prej syve të tillë** nga Rexhep Qosja

Një ndër librat më të bukur të letërsisë shqipe që di të tresë bukur esenë dhe letërsinë, të sjellë mendimet filozofike të konkretizuara në marrëdhëniet njerëzore.

**Te vdesësh nën diell** nga Ervin Nezhza.

Për mua ka qenë zbulimi i këtyre viteve, një shkrimtar i formuar me një stil të cilit i qëndron besnik, dhe që di të sjellë në

mënyrë të natyrshme filozofinë e thellë të jetës njerëzore përmes historive koncize që argëtojnë edhe përmes anekdotës.

**Një shaka e vogël me vdekjen.**

Në romanin tim më të fundit, kam zgjedhur argëtimin me vdekjen për të ofruar harenë dhe gëzimin e të jetuarit si një nga ndjesitë për të cilat kemi nevojë jo vetëm në kohë festash, por përditë.

Virion Graçi

**“Extra-Time”** – Durim Taçi; Roman original për nga stili, kompozicioni dhe tonet rrëfimtare; nga një histori e dhimbshme vetjake ka mundur të ndërtojë një histori romanore tërheqëse, estetikisht e arrirë.

**“Duartrokëtisit”** – Bashkim Hoxha; Me sigurinë dhe seriozitetin prej shkrimtari të sprovuar rrëfen objektivisht akte të jetës sonë publike ku grotesku dhe komikja nuk kanë nevojë të shpikën – mjafton perceptimi artistik dhe përfshirja e tyre në vepër në gjendjen kuazi-natyrë.

**“Mbyllur për pushime”** – Stefan Çapaliku; Retrospektivë fiskionale në histori duke përfshirë shkathtësisht njerëz, vende, episode të regjistrave nga hapësirave të ndryshme etno-kulturore rreth një ideje themelore – historia është e plotfuqishme dhe absurde në marrëdhëniet me secilën qenie njerëzore.

**“Vargmale nën dhë”** – Nurie Emrullai. Libër poetik individual me pasurinë e një botimi antologjik; larmia e motiveve të lëvruara dhe ligjërimi i kultivuar e bëjnë të andshëm leximin e poezive të saj.





# Pse u besojmë aq shumë influencuesve, shitësve dhe politikanëve që gënjejnë?



## Nga Bahador BAHRAMI

Shoqëria jonë drejtohet nga ndikimi shoqëror. Nga shitësi që dëshiron t'ju shesë një makinë, nga politikanë që dëshiron votën tuaj, dhe nga influencuesi në Tiktok që dëshiron që ju ta "pëlqeni", videot e tyre kanë një gjë të përbashkët: ata janë duke garuar për vëmendjen tuaj. Për shkencëtarët – në psikologji, politikë dhe shkenca kompjuterike – të kuptuarit se si u tërheqim vëmendjen njerëzve është një sfidë e veçantë. Në një studim të fundit, ne zbuluam se ndikimi social kuptohet më së miri si një konkurrencë. Shpesh njerëzit e mendojnë ndikimin social si një marrëdhënie direkte midis ndikuesit dhe objektivit të tyre. Por çdo zgjedhje ka të paktën dy kandidatë. Në mënyrë të ngjashme, mijëra video ngarkohen në TikTok çdo ditë, secila duke shpresuar të jetë ajo që do të bëhet virale. Dhe sa herë që një shitës shet një makinë, kolegët e tij konkurrentë humbasin një klient. Pra ndikimi është një lojë me shumën zero. Më shumë se si të ndikojmë tek njerëzit, pyetja është se si të jesh më me ndikim se të tjerët.

### Teoria e lojës

Ne projektuam një model laboratorik të ndikimit social, në formën e një loje që do të luhet nga tre persona: një klient

dhe dy këshilltarë. Klienti duhet të blejë një nga dy biletat e lotarisë, por nuk ka informacion se cila është më e mira.

Ndërkohë këshilltarët, të cilët kanë qasje private në një informacion të tillë, konkurrojnë për t'u punësuar nga klienti. Modeli ynë, ashtu si ndikimi social në jetën reale, është një lojë me shumën zero: suksesi i njërit prej këshilltarëve, është dështimi i tjetrit. Kjo na lejoi tapërdorim teorinë e lojës për të gjetur një strategji optimale për këshilltarin.

Analiza jonë e teorisë së lojës, tregoi se mund të formulohet një strategji e qartë: nëse tashmë kenë ndikim (nëse jeni i punësuar), mbani një qëndrim të paqartë dhe qëndrojeni pranë së vërtetës. Nëse, anasjelltas, jeni duke u shpërfillur, ngrijeni zërin, ekzagjerojeni gjërat, dhe nëse është e nevojshme gënjeni për të rënë në sy.

Ne kryem 7 eksperimente me më shumë se 800 pjesëmarrës që kanë luajtur rolin e klientit. Dhe zbuluam se shtrembërimi strategjik i së vërtetës, ia kalonte këshillimit të ndershëm për të fituar dhe mbajtur klientë të caktuar deri në 80 për qind të rasteve.

Kur këshilltarët ishin të pandershëm nga pikëpamja strategjike, ata arrinin t'i lëkundnin grupet e klientëve që zgjidhnin këshilltarin e tyre sipas një mënyre demokratike në çdo raund. Natyrisht kjo strategji është e njohur për cilindo që pa fushatën e Brexit,

të cilën e përshkruan shumë qartë ish-kryeministri britanik Dejvid Kameron në librin e tij "For the Record". Sipas Kamerone, Boris Xhonson luajti pikërisht kartën që do të pritej të luante kandidati i jo favorit (ai që sfidon presidentin aktual).

Kameron mbrojtëti qëndrimin e vendit në BE, ndaj Xhonson mbështeti fushatën që mbronte largimin nga unioni. Kameron shkruan se Xhonson bëri një zgjedhje strategjike për tadiferencuar veten nga pushtetarët. Xhonson, shkruan Kameron "rrezikoi me një rezultat në të cilin nuk besonte, pasi mendonte se ai do ta ndihmonte karrierën e tij politike".

Dhe për shkak se Xhonson ishte i sigurt se kauza që ai mbështeste do të humbiste, mbështetja ndaj saj solli pak rreziqe për të rrëzuar qeverinë që donte të drejtonte një ditë. "Ai do të ishte një bast i parrezikshëm për të" – shkruan Cameron.

### Tiparet e konkurrencës

Në qendër të këtij modeli ishin 3 shenjat dalluese të konkurrencës për ndikim social: asimetria e informacionit, delegimi i vendimeve të ardhshme dhe pasiguria. Asimetria e informacionit ndodh kur kërkuesit e ndikimit (politikanë ose këshilltarë), dinë më shumë për një çështje sesa njerëzit tek të cilët synojnë të ndikojnë (votuesit

ose klientët).

Në arenën politike, çështjet në fjalë janë shpesh shumë dimensionale dhe tejet komplekse që njerëzit të informohen plotësisht. Për shembull, në votimin e Brexit rajonet që favorizuan më shumë largimin nga unioni, ishin gjithashtu – për habinë e shumë votuesve – më të varurit nga tregjet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e tyre lokal.

Rivaliteti për ndikim social, përfshin shpesh një delegim të pushtetit: votuesit ose klientët u japin politikanëve apo menaxherëve të fondacioneve fuqinë për të marrë vendime të ardhshme në emër të tyre. Së fundmi, parashikimi i së ardhmes është i vështirë. Politologu Filip Tetlok, tregon në librin e tij të vitit 2017 "Ekspert Political Judgment" se si ekspertët që merren rregullisht me parashikimin e ngjarjeve të pasigurta të së ardhmes në financë, politikë apo sport, dalin shpeshherë bllof.

Konkurrenca për ndikim social, ka tendencën të zhvillohet në kushtet e një pasigurie të lartë mbi rezultatet. Nën këtë mjedis, është shumë i vështirë vlerësimi i saktësisë së këshillave. Dhe kjo gjë i jep mundësi këshilltarëve rivalë që të kërkojnë ndikim strategjik.

### Mbështetja publike

Gjetjet në studimin tonë, sugjerojnë se suksesi i

pandershmërisë është për shkak të gatishmërisë sonë për të nxituar në bërjen e përfundimeve paraprahe. Në rast se një këshilltar ishte i vetmi që parashikoi një rezultat të keq përpara se të ndodhte, ne priremi të mendojmë se ata duhet të kenë ditur diçka që të tjerët nuk e dinin.

Edhe pse kjo gjë mund të jetë ndonjëherë e vërtetë, shpesh gjithçka ndodh ka të bëjë thjeshtë me fatin. Një këshilltar strategjik përfiton nga gatishmëria që kemi për t'i besuar mendimit tonë të rrëmbyer për të rritur besimin e tyre.

Kur injorohet një këshilltar i ndershëm është më pak efektiv (sesa rivali i tij i pandershëm) për ta bindur klientin të ndryshojë qasje: përkushtimi ndaj ndershëmërisë i pengon ata të pozicionohen si një alternativë radikale nëse nuk ka prova për ta justifikuar atë. Këto lloj strategjish përdoren në mënyrë të përsëritur dhe të pamëshirshme nga ndikuesit e etur për vëmendje, pasi ato funksionojnë. Analiza jonë ndihmon në shpjegimin se pse politikanët që vazhdimisht gënjejnë, mund të vazhdojnë të gëzojnë mbështetjen e publikut. Shpresojmë që puna jonë të ndërgjegjësojë publikun dhe të na ndihmojë të gjithëve që të shohim strategji të tilla manipuluese dhe të pandershme, dhe t'i mbrojmë qytetarët kundër tyre. / "The Conversation" – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Shënuesit më të mirë në Superligën e meshkujve dhe femrave



**PRISHTINË, 27 DHJETOR** - Stinori vjeshtor në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll solli shumë përballje interesante, kurse më 'nxehtë' pritet në stinorin pranveror, ku do të vendoset gjithçka. Shënuesi më i mirë i stinorit vjeshtor është Dardan Berisha i Pejës me 24.1 pikë për ndeshje, duke qenë lojtari kryesor në skuadrën pejane në elitën e basketbollit të Kosovës. Ai pasohet nga dy basketbollistët e Prizrenit 16, Courtney Fells dhe Ivan Koljeviq, me nga 21.6, përkatësisht 21.3 pikëve për ndeshje. Organizatori i Dritës, Marcus Meyers, është në vendin e katërt me 21.3 pikë për ndeshje, kurse Stephen

Maxwell i Pejës përmbyll pesëshen më të mirë me 19 pikë për ndeshje. Ndërsa stinori vjeshtor përfundoi në Superligën e Femrave, ku Prishtina kishte dhjetë fitore në dhjetë ndeshje. Megjithatë, shënuesja me mesataren më të lartë të pikëve ishte Tasharra Jeffries e Trepçës me 37 pikë për ndeshje, duke mos harruar sfidën ndaj Kastriotit, ku shënoi 65 pikë. Pas saj u rendit Rael Whisitt e Penzës me 22.9 pikë për ndeshje, ndërsa është një nga basketbollistët më të mira në elitën e femrave. Kendra Williams e Vëllaznimit ishte afër saj me 22.8 pikë për ndeshje. Sarah Mgbeike pa dyshim ishte basketbollistja më e mirë në stinorin vjeshtor, duke e

ndihmuar Prishtinën të shpallet kampione vjeshtore, ndërsa kishte 21.9 pikë për ndeshje. Bashkëlojtarja e saj, Aisia Robertson, e mbyll top pesëshen me 17.6 pikë për ndeshje.

MESHKUJT - TOP 5 SHËNUESIT		
Dardan Berisha	(Peja)	24.1
Courtney Fells	(Prizreni 16)	21.6
Ivan Koljeviq	(Prizreni 16)	21.3
Marcus Meyers	(Drita)	20.6
Stephen Maxwell	(Peja)	19.0
FEMRAT - TOP 5 SHËNUESIT		
Tasharra Jeffries	(Trepça)	37
Rael Whisitt	(Penza)	22.9
Kendra Williams	(Vëllaznimi)	22.8
Sarah Mgbeike	(Prishtina)	21.9
Aisia Robertson	(Prishtina)	17.6

## SHKURT

### Rastet me Covid te Mali i Zi e shtyjnë miqësoren e hendbollit me Kosovën

Është anuluar miqësorja e hendbollit ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës që është dashur të zhvillohej të dielën me fillim nga ora 17:00 në Podgoricë. Skuadra jonë kishte udhëtuar të shtunën për në Podgoricë dhe ishte e gatshme për ndeshje. Por, te Mali i Zi janë paraqitur disa raste me koronavirus dhe për këtë arsye është vendosur të anulohet takimi. Vendimi u mor për ta ruajtur shëndetin e lojtarëve, përkatësisht për ta shmangur kontaktin me lojtarët e tjerë të Malit të Zi që mund të jenë bartës të virusit. Ekipi i hendbollit të Kosovës është kthyer në Prishtinë për t'i vazhduar stërvitjet për ndeshjet kualifikuese të janarit.

### Isufi zbulon votat për formacionin e vitit në Superligën e Kosovës

Tanimë është publikuar edhe formacioni i vitit në Superligën e Kosovës. Një nga trajnerët e parë që i ka zbuluar të gjitha votat e formacionit ka qenë Bekim Isufi. Trajneri gjilanas i shkarkuar ditë më parë nga Ballkani ka zbuluar në "Sportin Total" të KTV-së edhe emrat e lojtarëve të cilët i ka votuar. Në portë Isufi ka votuar Ardit Nikën e Prishtinës, ndërsa në mbrojtje Ardian Limanin, Lumbardh Dellovën, Jamal Aragon e Leonit Abazin. Në mesfushë Isufi ka votuar për Arbnor Ramadanin e Llapit që ka pasur një vit të jashtëzakonshëm, Lorik Boshnjakun dhe Endrit Krasniqin nga Prishtina. Ndërsa në repartin ofensivë Isufi ka votuar për Gerhard Prognin, Leotrim Kryeziun dhe Valmir Velium.

### Berisha emërohet ndihmëstrajner në FC Ferizaj

Klubi i FC Ferizaj e ka kompletuar stafin e trajnerit Arbnor Morina, duke emëruar ndihmëstrajner Fadil Berishën. Fadil Berisha ka qenë në të kaluarën pjesë e gjeneratës së artë të FC Prishtinës. Ai ishte edhe ndihmëstrajner i FC Prishtinës ku edhe e fitoi Kupën e Kosovës, gjithashtu edhe ndihmëstrajner i Përfaqësueses së Kosovës U17. "Me përvojën e tij në futbollin vendor dhe ndërkombëtar, ne si klub presim shumë që ai do të na ndihmojë në objektivat tona. Klubi ynë i uron mirëseardhje, duke i uruar shëndet e shumë suksese me FC Ferizaj", thuhet në njoftimin e klubit.

### Rekord rastesh me Covid në Premierligë

Një rekord prej 103 rastesh pozitive me Covid për shtatë ditë në Premierligë. Nga këto shifra në mesin e të infektuarve ka futbollistë dhe staf të klubeve të elitës së futbollit anglez. Rekordi i mëparshëm javor i ligës ishte 90 raste, i shpallur një javë më parë. Gjithsej 15 186 teste u kryen midis 20 dhe 26 dhjetorit, pasi Premierliga ka rifutur testimin e përditshëm të lojtarëve dhe stafit. Pesëmbëdhjetë ndeshje të Premierligës janë anuluar deri më tani gjatë dhjetorit për shkak të rasteve të koronavirusit.

## Trajneri i Southamptonit, elozhe Brojës: Është super i shpejtë

**SOUTHAMPTON, 27 DHJETOR** - Armando Broja ishte sërish i jashtëzakonshëm edhe ditën e sotme në duelin e radhës në Premierë Ligë ndaj West Hamit, duke fituar

një 11-metërsh, ndërkohë që në dy raste e detyroi arbitrin t'ua tregonte kartonin e verdhë rivalëve. Trajneri Hasenhuttl nuk i kursen elozhet për të pas

ndeshjes. "Broja është super i shpejtë. Ata kishin probleme me të në pjesën e parë dhe kjo është arsyeja pse mendoj se ishte diçka e mirë që gjyqtari shikoi edhe

një herë pamjet me VAR. Broja është shumë i rëndësishëm, absolutisht. Ai bëhet gjithnjë e më i mirë. I pëlqen këtu me ne, i pëlqen të luajë me ne, ndihet qetë

këtu dhe ka dëshirën të mësojë të punojë shumë. Kjo është ajo që bëjmë ne", ka thënë trajneri për sulmuesin e talentuar shqiptar pas suksesit 3-2 të skuadrës së tij.

## Wolff: Ja përse Hamiltoni ka vendosur të heshtë

LONDËR, 27 DHJETOR - Pasi humbi mundësinë të shpallet kampion bote në Formula 1 për të tetën herë, piloti britanik Lewis Hamilton ka vendosur të heshtë dhe të mos flasë me askënd. Ai

vendosi të mos ndjekë askënd në rrjetet sociale dhe prej gati 10 ditësh askush nuk di asgjë për pilotin e Mercedesit. "Hamiltoni është në heshtëje pasi nuk ka fjalë ta përshkruajë gjendjen e tij.

Atij iu vodh titulli kampion dhe ka mbetur i zhgënjyer me të gjithë. Është e vështirë të ecësh përpara kur sheh se është manipuluar besimi yt në sportin tënd të preferuar", u shpreh Toto Wolff, drejtor

sportiv i Mercedesit. Wolffi ka pranuar se Hamiltoni mund të mos garojë më në Formula 1 pas këtij zhgënjimi edhe pse britaniku ka një kontratë dyvjeçare me Mercedesin.



## Pique: Të dy janë më të mirët në historinë e futbollit, por Messi nuk është human

BARCELONË, 27 DHJETOR - Cristiano Ronaldo apo Lionel Messi, cili nga të dy yjet është më i zoti se tjetri?! Ka qenë ky një nga debatet më të mëdhenj në mbi 10 vjetët e fundit në botën e futbollit. Të dy futbollistët e sipërpërmendur ia kanë dalë të thyjnë rekord pas rekordi duke bërë që gjithnjë fokusi të jetë mbi ata. Në këtë formë opinioni sportiv gjithnjë është ndarë në dysh teksa një pjesë vlerëson më shumë punën e madhe të Ronaldos, ndërsa një pjesë tjetër Messin për talentin e tij. Së fundmi, rreth temës Messi apo Ronaldo ka folur edhe Gerard Pique, shok me argentinasiin për shumë vite të Barcelona. Mbrojtësi tregon se Ronaldo dhe Messi janë shumë të ndryshëm teksa thekson se portugezi është më i miri mes njerëzve, ndërsa "pleshti", thjesht, nuk është human me ato që bën në fushë. "Ata të dy janë të mrekullueshëm. Po flasim për dy



lojtarët më të mirë në historinë e futbollit. E kam thënë gjithnjë se Messi ka një talent që nuk e kanë të tjerët. Ai ia del ta kontrollojë shumë mirë topin kur e ka në kontroll dhe asnjëherë nuk e ka më shumë se dy metra larg topin nga këmba. Është e pamundur ta kapësh. Unë nuk kam parë asnjë

tjetër ta bëjë këtë. Nga ana tjetër, Ronaldo është ndryshe. Është më i kompletuar fizikisht, mund të shënojë në të gjitha mënyrat, me kokë, nga distanca, me driblim, penallti apo goditje dënimi... Por, për mua Messi nuk është human, ndërsa Ronaldo është më i miri i humanëve", ka shtuar Pique.

## Chicago synon kreun në Lindje, fitojnë edhe Denveri dhe Spursi

CHICAGO, 27 DHJETOR - Denveri ngjiti shkallet e renditjes në Perëndim pas fitores 103-100 në shtëpinë e Clippersit. Ndeshje me rivalitet, ku u dallua Jokiqi me 26 pikë e 22 rebounde. Fitoi edhe Miami, që mundi Orlando 93-83 Orlandon në derbin e Floridas, ndeshje ku Butleri e Martini realizuan nga 17 pikë secili. Nuk



zhgënjën skuadra e Memphisit, që mundi me rezultat 127-102 Sacramenton (Bane 28 pikë), ndërsa San Antonio mposhti thellë Detroitin me shifrat 144-

109 (Johnson 27 pikë). Chicago bëhet forca e dytë në Lindje pas fitores 113-105 ndaj Indianas, sfidë ku për vendasit u dallua LaVine me 32 pikë.

### REZULTATET

Miami - Orlando	93-83
Cleveland - Toronto	144-99
Sacramento - Memphis	102-127
Washington - Philadelphia	96-117
Oklahoma - New Orleans	117-112
San Antonio - Detroit	144-109
Chicago - Indiana	113-105
Clippers - Denver	100-103

## Tottenhami ofron 70 milionë euro për dy yjet e Juventusit

Tottenhami është duke u përgatitur që ta përforcojë skuadrën në afatin dimëror. Drejtori sportiv Fabio Paratici është në bisedime me trajnerin Antonio Conte për t'i parë përforcimet e radhës,

ndërsa dy yjet e Juventusit janë shënjestra kryesore. "Calciomercato" raporton se Tottenhami është gati të paguajë 70 milionë euro për dyshen e "Zonjës së Vjetër", Dejan Kulusevski dhe Weston

McKennie. McKennie është futbollisti të cilin Paratici e dërgoi te Juve nga Schalke 04, derisa do të provojë ta bindë për kalimin te "Spurs"-i. Amerikani nuk është i kënaqur me minutat te klubi

italian dhe është i hapur për largim, mirëpo Juventusit nuk e shet nën vlerën e 35 milionë eurove. Me të njëjtin çmim Juventusit e vlerëson edhe sulmuesin Dejan Kulusevski. Ideja e Tottenhamit është ta

huazojë për gjashtë muaj pastaj, nëse bind me paraqitje, do ta aktivizojë opsionin e blerjes. Ndërkohë, në garë për Paraticin interesim ka shprehur edhe rivali lokal, Arsenal.

### SHKURT

#### Nëse Strakosha largohet, Lazio transferon Handanoviçin

Thomas Strakosha nuk do ta rinovojë kontratën me Lazion pavarësisht se është rikthyer rregullisht titullar edhe në Serinë A. Strakosha po joshet gjithnjë e më shumë nga ideja për ta vijuar karrierën në Premierë Ligë, aty ku nuk mungojnë ofertat. Në këto kushte Tare duhet të lëvizë shpejt. Emri i parë në listë mbetet Kepa i Chelseas por, së fundmi, sipas medieve italiane, në skenë ka dalë edhe Samir Handanoviç. Kapiteni i Interit më 2006 erdhi te Lazio në formë huazimi, por luajti vetëm një ndeshje dhe më pas u largua pasi Lazio nuk pagoi 1 milion euro, aq sa ishte shuma e fiksuar për blerjen e kartonit. Në fund të këtij viti situata mund të ndryshojë sërish, nëse në Milano zbankon Onana, portieri i Ajaxit. Handanoviç mund ta shohë opsionin për të ndryshuar ambient dhe Lazio mbetet një pistë konkrete.

#### Wijnaldumi, transferimi i parë i Newcastleit

Newcastle Unitedi është në kërkim të përforcimeve për ta shpëtuar sezonin, të mbijetojë në Premierë Ligë dhe më pas të krijojë një skuadër ambicioze dhe fituese. Për këtë arsye klubi duket se ka ndër mend të kthejë në Angli Georginio Wijnaldum, i cili u transferua verën e kaluar te PSG, por nuk ka gjetur shumë hapësirë. Sipas "L'Equipe", holandezi nuk është në listën e lojtarëve që do të largohen nga klubi francez, por një ofertë e rëndësishme mund të ndryshojë gjithçka. Megjithatë, për momentin flitet për një huazim që nuk do të çonte para në arkat e PSG-së.

#### Lacazette do të largohet nga Arsenali

Sulmuesi francez pritet t'i japë fund përvojës me londinezët gjatë verës së ardhshme. Alexandre Lacazette do të largohet nga Arsenali gjatë verës tjetër. Për këtë siguron mediumi francez "L'Equipe". 30-vjeçarit i kanë mbetur vetëm edhe gjashtë muaj në kontratën e tij dhe në fund të sezonit do të jetë lojtar i lirë. Bëhet e ditur se "Gunners" është i interesuar ta vazhdojë bashkëpunimin me përfaqësuesin francez. Sidoqoftë, besohet se lojtari mendon se mund ta fitojë një kontratë afatgjatë diku tjetër. E ardhmja e Lacazettes mund të lidhet me La Ligan ose me Serinë A. Më pak i mundshëm është transferimi i tij në një klub tjetër të Premierligës.

#### Garë e fortë mes Realit dhe Cityt për Haalandin

Sulmuesi norvegjez Erling Haaland është më i kërkuar nga ekipet e mëdha në Evropë. Duket se do të jetë një duel i fortë midis Real Madridit dhe Manchester Cityt për t'i fituar shërbimet e bomberit norvegjez. Haalandi nuk e ka fshehur kurrë se do të dëshironte të luante në "Santiago Bernabeu" me klubin iberik, i cili e ka vendosur sulmuesin në listën e të parëve për ta transferuar në Madrid. Gjithashtu, nga ana tjetër është edhe klubi anglez i Manchester Cityt që kërkon shërbimet e sulmuesit të Dortmundit. Guardiola humbi në fillim Agueron i cili u transferua në Barcelonë e tashmë Ferran Torres u transferua në Barcelonë. Guardiola i ka kërkuar klubit t'i fillojë kontaktet e para me klubin e Dortmundit. Për të shuar konkurrencën, Manchester City ka kontaktuar agjentin e tij Raiola.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 25.12.2021 bënë shpallje publike për dhënie të pronës së paluajtshme me qira.

**Shpallje Publike - Korrigjim**

**T-21-010**

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave – Depoja Plastike - Industria e baterive  
Afati i fundit i dorëzimit: Në vend 11.02.2021 në 10:00 duhet të jetë **11.01.2022** në ora **10:00**  
Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.  
Parku Industrial, Mitrovicë

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

**RESTAURANT**

**SWISS  
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

▶ Besart Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Eqrem Çabej” Prishtinë.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lumë's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

